



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 23/07/2025

PROCES VERBAL

Konsultimi Publik për Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2027

Vendi : Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

Ora : 10:00

Tema e konsultimit : Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2027

I mbajtur sot më datë 23 Korrik në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Përmet me temë kryesore barazinë gjinore. Të pranishëm në këtë takim për prezantimin e Planit Vendor janë Nënkryetarja e Bashkisë Përmet znj. Aulona Meshini dhe Drejtoresha e Projekteve dhe Integritetit Europian znj. Klaudja Ciko. Gjithashtu në sallë ndodhen edhe shumë të pranishëm të interesuar lidhur me këtë temë mjaft të rëndësishme për komunitetin si perfaqesues nga OJF, institucione vendore, prinder etj.

Takimin e hapi Nënryetarja e Bashkisë Përmet e cila e vlerësoi këtë diskutim si mjaft të rëndësishëm. Më pas në vijim të fjalës së saj, ajo falenderoi të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij plani dhe pa humbur kohë filloi të prezantonte më hollësisht në detaje përmbajtjen e planit. Gjithashtu znj. Meshini theksoi se shkollat duhet të kenë një rol kyç lidhur me edukimin e femijëve ndaj këtyre temave të cilat janë bërë mjaft delikate kohët e fundit, pa harruar dhe familjen si bërthama e një shoqërie të rregullt.

Pasi bëri gjithë prezantimin e Planit të hartuar, ajo i falenderoi edhe një herë të gjithë pjesëmarrësit si dhe u dha atyre fjalën për të shprehur ide dhe sugjerime.

Të pranishmit në sallë e përgëzuan punën e bërë nga ana e Bashkisë Përmet duke e cilësuar si institucionin bazë për qytetin. Më pas ata ngritën disa problematika të listuara më poshtë :





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

- Të zbatohen të gjitha planet e hartuara duke ngritur grupe pune me profesioniste të fushave si dhe të monitorohet ecuria e zbatimit të planeve.
- Të luftohet fenomeni i bullizimit në shkolla ngritur si shqetësim nga disa prinder dhe përfaqësues të institucioneve arsimore.
- Bashkëpunim më të gjerë mes institucioneve duke bërë bashkë të gjithë aktoret dhe faktoret për zgjidhje të menjehershme të problematikave.
- Mbështetje për gratë e pastreha ngritur si shqetësim nga përfaqësues të Spitalit Bashkiak Permet duke theksuar sidomos raste të grave të pastreha dhe pa përkrahje të cilat duhen patur prioritet pasi shpesh janë objekt dhune dhe me të ekspozuara ndaj fenomeneve negative të shoqërisë.
- Fuqizim të gruas në zonat rurale ngritur si shqetësim nga Organizata Floemi, ku përfaqësuesi i të cilit u shpreh për fuqizimin e gruas në zonat rurale duke mundësuar pjesëmarrje dhe mundësi përfundimtare të barabartë në shoqëri.

Te gjitha sugjerimet janë marrë në konsideratë duke rishikuar pikat dhe objektivat e Draftit të Planit si dhe do të merren në konsideratë rekomandimet e ardhura në adresën elektronike të Koordinatorit të Konsultimit Publik.

Drafti do të qendrojë i publikuar edhe për 20 ditë në vazhdim duke pritur sugjerime dhe rekomandime nga grupe interesi apo komunitet.

Takimi u mbyll në orën **11:15**.

Konceptoi: Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

